

Dokumenti i Kualifikimit

Zhvilluesi i autorizuar:	Korporata e Investimeve Shqiptare
Emri i Projektit:	Zhvillimi i parkut teknologjik dhe shkencor “Durana Tech Park”
Titulli i Kontratës:	Menaxhimi/administrimi dhe ndërmjetësimi në përzgjedhjen e përdoruesve të “Durana Tech Park”
Lëshuar më:	28 Maj 2024

Dokumenti i Kualifikimit

Tabela e Përmbajtjes

PJESA 1 – Procedura e Kualifikimit	3
Seksioni I - Udhëzimet për Aplikantët.....	5
Seksioni II - Kushtet dhe Kriteret e Kualifikimit.....	17
Seksioni III - Formularët e Aplikimit	21
PJESA 2 – Përshkrimi i projektit.....	31
Seksioni IV - Përshkrimi i Projektit.....	33

PJESA 1 – Procedura e Kualifikimit

Seksioni I - Udhëzimet për Aplikantët

Përmbajtja

A. Të përgjithshme.....	7
1. Fusha e Aplikimit dhe Zhvilluesi i Autorizuar	7
2. Subjektet që mund të marrin pjesë.....	8
B. Dokumenti i Kualifikimit.....	9
3. Plotësia e Dokumentit të Kualifikimit.....	9
4. Sqarimi i Dokumentit të Kualifikimit	9
5. Ndryshimet e Dokumentit të Kualifikimit	10
C. Përgatitja e Aplikimeve.....	10
6. Kostoja e aplikimeve.....	10
7. Gjuha e aplikimit	10
8. Dokumentet që përbëjnë aplikimin	10
9. Letra për Aplikim.....	11
10. Dokumentet që vërtetojnë kualifikimet e Aplikantit	11
11. Nënshkrimi i aplikimit.....	11
D. Paraqitja e Aplikimeve.....	12
12. Përgatitja dhe emërtimi i aplikimeve	12
13. Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve.....	12
14. Aplikimet e vonuara.....	12
15. Hapja e aplikimeve.....	12
E. Procedura për Vlerësimin e Aplikimeve	12
16. Konfidencialiteti	12
17. Sqarimi i aplikimeve.....	13
18. Vlefshmëria e aplikimeve	13
19. Nënkontraktorët	13
20. Vlerësimi i aplikimeve.....	13
21. E drejta e Korporatës për të pranuar ose refuzuar aplikimet	13
22. Kualifikimi i Aplikantëve	14
23. Njoftimi i Kualifikimit.....	14
24. Kërkesa për Propozim.....	14
25. Ndryshimet në strukturën ligjore të Aplikantëve.....	14
26. Ankesa në lidhje me procedurën.....	15

Seksioni I - Udhëzimet për Aplikantët

A. Të përgjithshme

1. Fusha e Aplikimit dhe Zhvilluesi i Autorizuar

- 1.1. Korporata është caktuar si zhvillues i Korporata është caktuar si zhvillues i autorizuar i parkut teknologjik dhe shkencor “Durana Tech Park”, me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 185, datë 27.03.2024.vendim i cili ndër të tjera, vendosi:
 - a. miratimin e hapjes së parkut teknologjik dhe shkencor, me emërtimin “Durana Tech Park”, me sipërfaqe 140 400 (njëqind e dyzet mijë e katërqind) m², me vendndodhje në Xhafzotaj, Bashkia Durrës, Shqipëri, në pasurinë me nr. 336, e llojit “truall”, në zonën kadastrale 3852;
 - b. kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit disa pasuri të paluajtshme shtetërore të llojit truall, me një sipërfaqe totale prej 262,200 m², me vendndodhje në Komunën Xhafzotaj, në Rrethin e Durrësit, për t’u përdorur për krijimin/hapjen e parkut teknologjik dhe shkencor “Durana Tech Park”;
 - c. llojet e veprimtarive që do të zhvillohen në “Durana Tech Park”, për të cilat zhvilluesi dhe përdoruesit të cilët regjistrohen në park përfitojnë lehtësira rregullatore, fiskale dhe doganore, sipas kushteve dhe parashikimeve ligjore;
 - d. miratimin e ndihmës me infrastrukturën e përgjithshme mbështetëse deri në kufijtë e parkut, si rrugë, fibra optike, energji elektrike, por pa u kufizuar në to sipas parashikimeve të nenit 11 të ligjit mbi parqet teknologjike.
2. Korporata për zhvillimin e Durana Tech Park synon të përzgjedhë një partner për të lidhur një marrëveshje të përbashkët për të siguruar përmbushjen e kushteve të nevojshme për zhvillimin dhe menaxhimin e Durana Tech Park, përmes krijimit të një SPV (Special Purpose Vehicle).
3. Korporata publikon këtë Dokument Kualifikimi për Aplikantët e mundshëm të interesuar për të dorëzuar aplikimet për kualifikim dhe për të paraqitur propozime për Projektin e përshkruar në Seksionin IV (Përshkrimi i Projekti).
4. Adresa e Korporatës përcaktohet në Ftesën për Shprehje Interesi.

2. Subjektet që mund të marrin pjesë

- 2.1 Një Aplikant mund të jetë një person fizik ose juridik, privat ose publik, si dhe institucione të arsimit të lartë ose një bashkim i subjekteve të tilla në formën e një shoqërie të përbashkët (JV) ose bashkimi subjektsh sipas një marrëveshjeje për këtë projekt ose që synojnë për të hyrë në një marrëveshje të tillë të dokumentuar nga një marrëveshje paraprake me shkrim. Bashkimi i subjekteve do të emërojë një përfaqësues, i cili do të ketë autoritetin për të kryer të gjitha veprimet për dhe në emër të secilit dhe të gjithë anëtarëve të bashkimit, gjatë procesit të kualifikimit, propozimit (nëse është rasti) dhe gjatë negociatave për lidhjen e kontratës (nëse është rasti).
- 2.2 Një subjekt mund të aplikojë për kualifikim dhe të kualifikohet njëkohësisht individualisht, si pjesë e një bashkimi subjektsh ose si nënkontraktor. Në fazën e dytë, Aplikanti i kualifikuar nuk mund të paraqesë disa propozime, si subjekt individual, si anëtar i një shoqërie të përbashkët apo si nënkontraktor. Megjithatë, një subjekt mund të marrë pjesë si nënkontraktor në më shumë se një propozim, por vetëm në këtë cilësi. Propozimet e paraqitura në kundërshtim me këtë rregull do të refuzohen.
- 2.3 Një subjekt dhe çdo filial/subjekt i lidhur me të (që drejtpërdrejt ose indirekt kontrollon, kontrollohet ose është nën kontroll të përbashkët me atë subjekt) mund të paraqesin kërkesën e tyre për kualifikim individualisht, si shoqëri e përbashkët ose si nënkontraktor ndërmjet tyre. Megjithatë, nëse kualifikohen, vetëm një aplikant i kualifikuar ndërmjet tyre do të lejohet të paraqesë propozim në fazën e dytë të konkurimit. Të gjitha propozimet e paraqitura në kundërshtim me këtë rregull do të refuzohen.
- 2.4 Një subjekt nuk mund të marrë pjesë në këtë procedurë në rast se Aplikanti është:
- a. i themeluar dhe rregjistruar në një vend për të cilin, me një akt pajtueshmërie me një vendim të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të marrë sipas Kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara, për shkak të një ligji ose rregullore zyrtare, Republika e Shqipërisë ndalon çdo import të mallrave ose kontraktim të punëve, mallrave ose shërbimeve nga ai vend, ose çdo pagesë për një person ose subjekt të rregjistruar në atë vend;
 - b. subjekt i parashikuar në pikat 1 e 2, të nenit 3, të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e

krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar, si dhe

- c. subjekt i aktit normativ nr.1, datë 31.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit dhe sigurisë publike”.

- 2.5 Aplikantët nuk duhet të kenë konflikt interesi. Aplikantët do të konsiderohen se kanë konflikt interesi, nëse ata, ose ndonjë prej filialeve të tyre, kanë marrë pjesë si konsulent në përgatitjen e projektit ose specifikimeve teknike që janë objekt i këtij kualifikimi. Për më tepër, aplikantët mund të konsiderohen të kenë konflikt interesi nëse kanë një marrëdhënie të ngushtë biznesi ose familjare me një staf profesional të Korporatës, i cili është përfshirë drejtpërdrejt në përgatitjen e Dokumentit të Kualifikimit, Kërkesës për Propozim, dhe/ose procesin e vlerësimit të propozimeve të kësaj Kontrate.

B. Dokumenti i Kualifikimit

3. Plotësia e Dokumentit të Kualifikimit

- 3.1 Korporata nuk pranon asnjë përgjegjësi për plotësinë e Dokumentit të Kualifikimit përveç rasteve kur dokumenti tërhiqet drejtpërdrejt nga faqja e internetit të Korporatës. Kjo përfshin edhe përgjigjet ndaj kërkesave për sqarim, ose shtesat/ndryshimet në Dokumentin e Kualifikimit.
- 3.2 Aplikanti duhet të shqyrtojë të gjitha udhëzimet, formularët dhe kushtet në Dokumentin e Kualifikimit dhe të dorëzojë me aplikimin e tij të gjithë informacionin ose dokumentacionin siç kërkohet nga Dokumenti i Kualifikimit.

4. Sqarimi i Dokumentit të Kualifikimit

- 4.1 Një Aplikant që kërkon sqarime të Dokumentit të Kualifikimit duhet të kontaktojë me shkrim Korporatën në adresën si vijon:

Person kontakti: Zj. Valentina Kazanxhi

E-mail: valentina.kazanxhi@aicorporation.al
- 4.2 Korporata do t'i përgjigjet me shkrim çdo kërkesë për sqarim me kusht që kërkesa e tillë të merret jo më vonë se **dhjetë (10) ditë** para afatit të fundit për dorëzimin e aplikimeve. Korporata do t'a publikojë menjëherë përgjigjen e saj në faqen e internetit të saj, të dhënë në Ftesën për Shprehje Interesi, duke përfshirë një përshkrim të kërkesës, por pa identifikuar burimin e saj. Nëse Korporata e sheh të nevojshme të ndryshojë Dokumentin

e Kualifikimit si pasojë e një kërkesë për sqarim, ajo do ta bëjë këtë duke ndjekur procedurën sipas përcaktimeve në këto udhëzime.

5. Ndryshimet e - Dokumentit të Kualifikimit

5.1 Korporata, për çdo lloj arsye, me nismën e vet ose me kërkesë për sqarim nga një Aplikant, mund të bëjë ndryshime në Dokumentin e Kualifikimit nëpërmjet hartimit të një Shtojce, e cila do të publikohet menjëherë në rrugë elektronike në faqen zyrtare të internetit të Korporatës, të përcaktuar në Ftesën për Shprehje Interesi. Aplikantët duhet të vizitojnë faqen e internetit të Korporatës rregullisht për t'u informuar me këto ndryshime (nëse është rasti). Çdo Shtojcë e lëshuar do të jetë pjesë e Dokumentit të Kualifikimit.

5.2 Për t'u dhënë Aplikantëve kohë të arsyeshme për të marrë parasysh kërkesat e dhëna në Shtojcë në përgatitjen e aplikimeve të tyre, Korporata mund të zgjasë afatin për dorëzimin e aplikimeve deri në **7 (shtatë) ditë**.

C. Përgatitja e Aplikimeve

6. Kostoja e aplikimeve

6.1 Aplikanti do të përballojë të gjitha shpenzimet që lidhen me përgatitjen dhe dorëzimin e aplikimit të tij. Korporata në asnjë rast nuk do të jetë përgjegjëse ose e detyruar për këto kosto, pavarësisht nga zhvillimi ose rezultati i procesit të kualifikimit.

7. Gjuha e aplikimit

7.1 Aplikimi, si dhe të gjitha korrespondencat dhe dokumentet e shkëmbyera nga Aplikanti dhe Korporata, që kanë të bëjnë me kualifikimin, do të përgatiten në gjuhët shqip ose anglisht. Dokumentet mbështetëse që janë pjesë e aplikimit mund të jenë në një gjuhë tjetër, me kusht që të shoqërohen nga një përkthim zyrtar në gjuhët shqip ose anglisht. Në këtë rast, për qëllime të interpretimit të aplikimit, do të merret në konsideratë përkthimi.

8. Dokumentet që përbëjnë aplikimin

8.1 Aplikimi do të përmbajë sa vijon:

- (a) Letrën e Aplikimit;
- (b) Prokurën ose autorizimin me shkrim që autorizon nënshkruenin e aplikimit për të angazhuar Aplikantin, në rastin kur ky i fundit nuk është përfaqësuesi ligjor i Aplikantit;
- (c) Formularët e aplikimit dhe dokumentat e kërkuar që vërtetojnë kualifikimet e Aplikantit; dhe
- (d) çdo dokument tjetër të kërkuar siç specifikohet në këto

udhëzime.

- 9. Letra për Aplikim**
- 9.1 Për dorëzimin e aplikimit, Aplikanti duhet të plotësojë një Letër për Aplikim siç parashikohet në Seksionin III (Formularët e Aplikimit). Kjo Letër duhet të plotësohet pa asnjë ndryshim në formatin e saj.
- 10. Dokumentet që vërtetojnë kualifikimet e Aplikantit**
- 10.1 Për të demonstruar se kualifikimet e tij përmbushin kriteret e kualifikimit në përputhje me Seksionin II, Kriteret e Kualifikimit, Aplikanti do të ofrojë informacionin e kërkuar në formularët përkatës informativë të përfshira në Seksionin III (Formularët e Aplikimit).
- 10.2 Kudo që një formular aplikimi kërkon që një Aplikant të deklarojë një shumë monetare, Aplikantët duhet të tregojnë ekuivalentin në EURO duke përdorur kursin e këmbimit të përcaktuar si më poshtë:
- për të dhënat financiare vjetore - Kursi i këmbimit të Bankës së Shqipërisë në ditën e fundit të vitit kalendarik përkatës (me të cilin do të konvertohen shumat për atë vit);
 - për vlerën e kontratës - kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën e lidhjes së kontratës.
- Çdo gabim në përdorimin e kurseve të mësipërme të këmbimit në aplikim mund të korrigjohet nga Korporata.
- 11. Nënshkrimi i aplikimit**
- 11.1 Aplikimi do të shtypet ose shkruhet me bojë të pashuajteshme dhe do të nënshkruhet nga një person i autorizuar për të nënshkruar në emër të Aplikantit.
- 11.2 Në rast se Aplikanti është bashkim subjektsh, aplikimi nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar në emër të bashkimit të subjekteve, në mënyrë që të jetë ligjërish i detyrueshëm për të gjithë anëtarët, siç dëshmohet nga një autorizim i nënshkruar/prokurë e lëshuar nga përfaqësuesit e tyre ligjërish të autorizuar.
- 11.3 Aplikantët, të cilët paraqiten në konkurrim, duhet të paraqesin dokumentet në format dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar. Aplikantët e huaj, duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj (i pajisur me vulë apostile nga shteti i origjinës). Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, aplikanti duhet të vetëdeklarojë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur. Në çdo rast, Korporata ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga aplikanti, si më sipër, ose t'i kërkojë Aplikantit sqarime dhe dokumente

mbështetëse.

D. Paraqitja e Aplikimeve

- 12. Përgatitja dhe emërtimi i aplikimeve**
- 12.1 Aplikanti duhet të përgatisë aplikimin në format shkresor dhe do të përgatisë një kopje elektronike të aplikimit në format elektronik CD/USB (read-only) të paeditueshëm.
- 12.2 Aplikanti do të fusë në të njëjtin zarf aplikin në format shkresor dhe kopjen elektronike në format CD/USB dhe do ta dorëzojë këtë zarf të mbyllur, ku të shënohet me shkrim të lexueshëm dhe të qartë:
- (a) “APLIKIM”
 - (b) të mbajë emrin dhe adresën e Aplikantit;
 - (b) t'i dërgohet Korporatës, në mënyrën e përcaktuar në këto udhëzime; dhe
 - (c) të mbajë emrin e projektit të përcaktuar në Ftesën për Shprehje Interesi.
- 12.3 Korporata nuk do të pranojë asnjë përgjegjësi për mospranimin e asnjë zarfi që nuk i është dërguar siç kërkohet **në pikën 12.1**.
- 13. Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve**
- 13.1 Aplikantët mund të dorëzojnë aplikimet e tyre dorazi ose me postë. Aplikimet do të pranohen nga Korporata jo më vonë se afati i përcaktuar në Ftesën për Shprehje Interesi.
- 14. Aplikimet e vonuara**
- 14.1 Aplikimet e marra pas afatit të fundit për dorëzimin e aplikimeve do të refuzohen.
- 15. Hapja e aplikimeve**
- 15.1 Korporata do të hapë të gjitha aplikimet në datën, kohën dhe vendin e specifikuar në Ftesën për Shprehje Interesi. Aplikimet e vonuara do të trajtohen në përputhje me **pikën 14.1**.
- 15.2 Korporata do të përgatisë një procesverbal të hapjes së aplikimeve duke përfshirë, së paku, emrat e Aplikantëve. Një kopje e procesverbalit do t'u shpërndahet të gjithë Aplikantëve.

E. Procedura për Vlerësimin e Aplikimeve

- 16. Konfidencialiteti**
- 16.1 Informacioni në lidhje me aplikimet, vlerësimin e tyre dhe rezultatet e kualifikimit nuk do t'u bëhet me dije Aplikantëve ose ndonjë personi tjetër që nuk është zyrtarisht i interesuar në procesin e kualifikimit derisa të gjithë Aplikantët të njoftohen për rezultatet e kualifikimit.

- 17. Sqarimi i aplikimeve**
- 17.1 Korporata mund t'i kërkojë Aplikantëve sqarime të aplikimeve të tyre, që duhet të dorëzohen brenda një periudhe të arsyeshme kohore të përcaktuar. Çdo kërkesë për sqarim nga Korporata dhe të gjitha sqarimet e dhëna nga Aplikantët do të jenë me shkrim.
- 17.2 Nëse një Aplikant nuk ofron sqarime dhe/ose dokumente të kërkuara deri në datën dhe kohën e caktuar në kërkesën e Korporatës për sqarim, aplikimi i tij do të vlerësohet bazuar në informacionin dhe dokumentet në dispozicion në kohën e vlerësimit të aplikimit.
- 18. Vlefshmëria e aplikimeve**
- 18.1 Korporata mund të refuzojë çdo aplikim që nuk i përgjigjet kërkesave të Dokumentit të Kualifikimit. Në rast se informacioni i dhënë nga Aplikanti është i paplotë ose kërkon sqarim sipas përcaktimeve në këto udhëzime dhe Aplikanti dështon të japë sqarime të kënaqshme dhe/ose informacionin e munguar, aplikimi i tij mund të refuzohet.
- 19. Nënkontraktorët**
- 19.1 Korporata, mund të lejojë Aplikantin të propozojë nënkontraktorë për disa pjesë të projektit. Aplikantët që planifikojnë të përdorin nënkontraktorë të tillë duhet të specifikojnë, në Letrën e Aplikimit, aktivitetin(et) ose pjesët e projektit të propozuara për t'u nënkontraktuar së bashku me të dhënat e nënkontraktorëve të propozuar, duke përfshirë kualifikimin dhe përvojën e tyre.
- 20. Vlerësimi i aplikimeve**
- 20.1 Korporata do të përdorë vetëm metodat, kriteret dhe kërkesat e përcaktuara në Seksionin II, Kriteret e Kualifikimit, për të vlerësuar kualifikimet e Aplikantëve. Korporata rezervon të drejtën të pranojë devijime të vogla nëse ato nuk ndikojnë materialisht në aftësinë teknike dhe burimet financiare të një Aplikanti për të përmbushur qëllimin e projektit.
- 20.2 Nënkontraktorët e propozuar nga Aplikanti duhet të jenë plotësisht të kualifikuar për zbatimin e pjesëve të tyre të projektit.
- 20.3 Në vlerësimin e një aplikimi, vetëm kualifikimet e Aplikantit do të merren parasysh, me përjashtim të rasteve kur Korporata përcakton në Seksionin II - Kushtet dhe Kriteret e Kualifikimit, se Aplikanti mund të plotësojë kriteret të vecanta në bashkëpunim me partnerët/nënkontraktorët e tij.
- 21. E drejta e Korporatës për të pranuar ose refuzuar aplikimet**
- 21.1 Korporata rezervon të drejtën të pranojë ose refuzojë çdo aplikim, të anulojë procesin e kualifikimit dhe të refuzojë të gjitha aplikimet në çdo kohë, pa marrë asnjë përgjegjësi ndaj Aplikantëve.

- 22. Kualifikimi i Aplikantëve**
- 22.1 Të gjithë Aplikantët, aplikimet e të cilëve në thelb plotësojnë ose tejkalojnë kërkesat e specifikuara të kualifikimit do të kualifikohen nga Korporata.
- 22.2 Një Aplikant mund të jetë "i kualifikuar me kusht", domethënë, i kualifikuar me kusht që Aplikanti të dorëzojë ose korrigjojë dokumente ose mangësi të caktuara jomateriale që plotësojnë kërkesat e Korporatës.
- 22.3 Aplikantët që janë të kualifikuar me kusht do të informohen për kushtet të cilat duhet të plotësohen në mënyrë të pranueshme për Korporatën para ose në kohën e dorëzimit të propozimeve të tyre.
- 23. Njoftimi i Kualifikimit**
- 23.1 Korporata do t'i njoftojë me shkrim nëpërmjet postës elektronike të gjithë Aplikantët për emrat e Aplikantëve të cilët janë kualifikuar ose kualifikuar me kusht. Gjithashtu, ata Aplikantë që janë skualifikuar do të informohen veçmas për rezultatet e procedurës dhe arsytet e skualifikimit.
- 24. Kërkesa për Propozim**
- 24.1 Menjëherë pas njoftimit të rezultateve të kualifikimit, dhe kalimit të afateve të ankimimit ose pas adresimit të kënaqshëm të çdo ankese që është paraqitur brenda periudhës së ankimimit, Korporata do të ftojë të gjithë Aplikantët që janë kualifikuar ose kualifikuar me kusht për të dorëzuar propozime.
- 24.2 Kandidatëve mund t'u kërkohet të japin një Sigurim të Propozimit të pranueshme për Korporatën në formën dhe shumën e specifikuar në Kërkesën për Propozim.
- 24.3 Përpara lidhjes së kontratës së menaxhimit, Korporata do të verifikojë nëse ndonjë nënkontraktor i propozuar nuk plotëson kërkesat dhe nëse është rasti, do të kërkojë nga Kandidati të propozojë një nënkontraktor tjetër.
- 25. Ndryshimet në strukturën ligjore të Aplikantëve**
- 25.1 Çdo ndryshim në strukturën ligjore të një Aplikanti pasi është kualifikuar dhe është ftuar për të paraqitur propozim (përfshirë, rastin e një bashkimi subjektsh, çdo ndryshim në strukturën ligjore ose formën e çdo anëtari, përfshirë edhe çdo ndryshim në ndonjë nënkontraktor, kualifikimet e të cilit konsiderohen se kualifikojnë Aplikantin) do t'i nënshtrohet miratimit me shkrim të Korporatës përpara afatit të fundit për dorëzimin e propozimeve. Një miratim i tillë do të refuzohet nëse si pasojë e ndryshimit, Aplikanti në thelb nuk i plotëson më kriteret e kualifikimit të përcaktuara në Seksionin II (Kriteret e Kualifikimit).
- 25.2 Çdo ndryshim i tillë duhet t'i dorëzohet Korporatës jo më vonë se **katërmbëdhjetë (14) ditë** pas datës së marrjes së Kërkesës

për Propozim nga Korporata.

26. Ankesa në lidhje me procedurën

26.1 Nëse një Aplikant dëshiron të bëjë një ankesë lidhur me konkurimin, Aplikanti do të paraqesë ankesën e tij me email, në adresën:

Për vëmendje : Valentina Kazanxhi

Adresa e emailit : valentina.kazanxhi@aicorporation.al

26.2 Në këtë fazë, një ankesë lidhur me konkurimin mund të bëhet për një nga arsyet e mëposhtme:

1. termat e Dokumentit të Kualifikimit; dhe
2. vendimin e Korporatës për të mos kualifikuar një Aplikant.

26.3 Periudha e ankimimit, në lidhje me vendimin e Korporatës për të mos kualifikuar një Aplikant, fillon ditën e njoftimit të aplikantëve për rezultatet e kualifikimit dhe do të jetë pesë (5) ditë.

26.4 Periudha e ankimimit, në lidhje me termat e Dokumentit të Kualifikimit, fillon ditën e publikimit të Ftesës për Shprehje Interesi dhe do të jetë pesë (5) ditë.

26.5 Kur dorëzohet vetëm një aplikim, periudha e ankimimit nuk do të zbatohet.

26.6 Korporata do ti shqyrtojë ankesat në bazë të procedurës së ankimimit të përcaktuar në Rregulloren e Procedurës së Konkurimit, të publikuar në faqen e internetit të saj.

Seksioni II - Kushtet dhe Kriteret e Kualifikimit

Ky seksion përmban të gjitha metodat, kriteret dhe kërkesat që Korporata do të përdorë për të vlerësuar Aplikimet. Informacioni që duhet dhënë në lidhje me çdo kërkesë dhe përkufizimet e termave përkatës përfshihen në formularët përkatës të aplikimit në Seksionin III.

Përmbajtja

1. Kriteret Administrative dhe Ligjore.....	18
2. Kriteret Financiare	18
3. Kriteret Teknike.....	19

		Kërkesat për Aplikantët					Formulari që paraqitet
Nr.	Kriteret e kualifikimit	Shoqëri e vetme	Shoqëri e Përbashkët ose Bashkim Subjektsh			Nën-kontraktor	
			Të gjithë anëtarët të kombinuar	Çdo Anëtar	Një Anëtar		
1. Kriteret Administrative dhe Ligjore							
1.1	Informacion mbi Aplikantin	Duhet të plotësojë kërkesën	Duhet të plotësojë kërkesën	Duhet të plotësojë kërkesën	N/A	N/A	Formularët 1.1 dhe 1.2
1.2	Aplikanti nuk është në proces falimentimi dhe / ose likuidimi	Duhet të plotësojë kërkesën	Duhet të plotësojë kërkesën	Duhet të plotësojë kërkesën	N/A	N/A	Formularët 1.1 dhe 1.2
1.3	Aplikanti nuk është dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për vepra kundër pasurisë, në sferën ekonomike dhe veprimtarinë profesionale	Duhet të plotësojë kërkesën	Duhet të plotësojë kërkesën	Duhet të plotësojë kërkesën	N/A	N/A	Formularët 1.1 dhe 1.2
1.4	Kapitalet dhe asetet e Aplikantit nuk janë objekt i procedurave të ekzekutimit të detyrueshëm nga ana e shërbimit përmbarimor	Duhet të plotësojë kërkesën	Duhet të plotësojë kërkesën	Duhet të plotësojë kërkesën	N/A	N/A	Letra e Aplikimit
1.5	Aplikanti i ka përmbushur rregullisht detyrimet në lidhje me pagesat e taksave dhe të tatimeve	Duhet të plotësojë kërkesën	Duhet të plotësojë kërkesën	Duhet të plotësojë kërkesën	N/A	N/A	Letra e Aplikimit
1.6	Aplikanti i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore	Duhet të plotësojë kërkesën	Duhet të plotësojë kërkesën	Duhet të plotësojë kërkesën	N/A	N/A	Letra e Aplikimit
1.7	Aplikanti nuk ndodhet në kushtet e parashikuara nga Neni 131 i Ligjit Nr. 9920/2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”	Duhet të plotësojë kërkesën	Duhet të plotësojë kërkesën	Duhet të plotësojë kërkesën	N/A	N/A	Letra e Aplikimit
1.8	Aplikanti nuk është subjekt i masave me karakter administrativ	Duhet të plotësojë kërkesën	Duhet të plotësojë kërkesën	Duhet të plotësojë kërkesën	N/A	N/A	Letra e Aplikimit
1.9	Aplikanti nuk është në ndjekje penale për vepra kundër pasurisë, në sferën ekonomike dhe veprimtarinë profesionale	Duhet të plotësojë kërkesën	Duhet të plotësojë kërkesën	Duhet të plotësojë kërkesën	N/A	N/A	Letra e Aplikimit
2. Kriteret Financiare							

		Kërkesat për Aplikantët					Formulari që paraqitet
Nr.	Kriteret e kualifikimit	Shoqëri e vetme	Shoqëri e Përbashkët ose Bashkim Subjektësh			Nën-kontraktor	
			Të gjithë anëtarët të kombinuar	Çdo Anëtar	Një Anëtar		
2.1	Aplikanti ka stabilitet ekonomik dhe financiar, e demonstruar kjo nëpërmjet raportit aktive/detyrime, ku aktivet afatshkurtra tejkalojnë detyrimet afatshkurtra gjatë tre (3) viteve të fundit.	Duhet të plotësojë kërkesën	Duhet të plotësojë kërkesën	Duhet të plotësojë kërkesën	N/A	N/A	Formulari 2.1
2.2	Aplikanti ka kapacitet financiar për financimin e zhvillimit / menaxhimit të parkut në masën jo më pak se 10 (dhjetë) milionë Euro. Aplikanti do të listojë burimet e propozuara të financimit.	Duhet të plotësojë kërkesën	Duhet të plotësojë kërkesën	N/A	Duhet të plotësojë kërkesën	N/A	Formulari 2.2
3. Kriteret Teknike							
3.1	Aplikanti, vetë apo nëpërmjet nënkontraktorëve të tij, siguron eksperiencë në projekte të ngjashme në lidhje me zhvillimin dhe / ose menaxhimin e një parku teknologjik	Duhet të plotësojë kërkesën	Duhet të plotësojë kërkesën	N/A	Duhet të plotësojë kërkesën	Duhet të plotësojë kërkesën	Formulari 3.1 Letra e Aplikimit
3.2	Aplikanti, vetë apo nëpërmjet nënkontraktorëve të tij, siguron licensat profesionale që lidhen me kryerjen e punimeve që do të parashikohen në planin e zhvillimit.	Duhet të plotësojë kërkesën	Duhet të plotësojë kërkesën	N/A	Duhet të plotësojë kërkesën	Duhet të plotësojë kërkesën	Letra e Aplikimit
3.3	Aplikanti, vetë apo nëpërmjet nënkontraktorëve të tij, siguron kualifikimet arsimore dhe profesionale të stafit përgjegjës në lidhje me realizimin e planit të zhvillimit	Duhet të plotësojë kërkesën	Duhet të plotësojë kërkesën	N/A	Duhet të plotësojë kërkesën	Duhet të plotësojë kërkesën	Letra e Aplikimit
3.4	Aplikanti, vetë apo nëpërmjet nënkontraktorëve të tij, siguron fuqinë mesatare punëtore në lidhje me realizimin e planit të zhvillimit.	Duhet të plotësojë kërkesën	Duhet të plotësojë kërkesën	N/A	Duhet të plotësojë kërkesën	Duhet të plotësojë kërkesën	Letra e Aplikimit
3.5	Aplikanti, vetë apo nëpërmjet nënkontraktorëve të tij, siguron pajisje, mjete, pajisje teknike për të realizuar	Duhet të plotësojë kërkesën	Duhet të plotësojë kërkesën	N/A	Duhet të plotësojë kërkesën	Duhet të plotësojë kërkesën	Letra e Aplikimit

		Kërkesat për Aplikantët					Formulari që paraqitet
Nr.	Kriteret e kualifikimit	Shoqëri e vetme	Shoqëri e Përbashkët ose Bashkim Subjektsh			Nën-kontraktor	
			Të gjithë anëtarët të kombinuar	Çdo Anëtar	Një Anëtar		
	punimet që do të parashikohen në planin e zhvillimit						
3.6	Propozon përfshirjen e një institucioni të arsimit të lartë, vendës ose të huaj, të akredituar sipas legjislacionit përkatës të vendit të origjinës.	Duhet të plotësojë kërkesën	Duhet të plotësojë kërkesën	N/A	N/A	N/A	Letra e Aplikimit

Seksioni III - Formularët e Aplikimit

Tabela e Formularëve

Letra e Aplikimit.....	22
Formulari 1.1 Kriteri Ligjor - Administrativ i Aplikantit.....	24
Formulari 1.2 Kriteri Ligjor - Administrativ i Anëtarëve të Aplikantit	25
Formulari 2.1 Stabiliteti Ekonomik dhe Financiar	27
Formulari 2.2 Kapaciteti Financiar	29
Formulari 3.1 Eksperienca e Ngjashme.....	30

Letra e Aplikimit

Data: *[fut ditën, muajin dhe vitin]*
 Emri i Projektit: Zhvillimi i parkut teknologjik dhe shkencor “Durana Tech Park”
 Titulli i Kontratës: Menaxhimi/administrimi dhe ndërmjetësimi në përzgjedhjen e
 përdoruesve të “Durana Tech Park”

Për: Korporata e Investimeve Shqiptare

Ne, të nënshkruarit, aplikojmë për t'u kualifikuar për kontratën e referuar më sipër dhe deklarojmë se:

- a. **Rezerva:** Ne kemi shqyrtuar dhe nuk kemi rezerva për Ftesën për Shprehje Interesi, duke përfshirë Shtojcën(at) e lëshuar/a për Aplikantët: *[futni numrin dhe datën e lëshimit të çdo shtojce]*;
- b. **Konflikt interesi:** Nuk kemi konflikt interesi në përputhje me pikën 2.5 të Udhëzimeve për Aplikantët;
- c. **Pranueshmëria:** Ne (dhe nënkontraktorët tanë) plotësojmë kërkesat e pranueshmërisë në përputhje me pikën 2.4 të Udhëzimeve për Aplikantët;
- d. **Vlefshmëria e aplikimit:** Ne (dhe nënkontraktorët tanë) plotësojmë kriteret administrative, ligjore dhe teknike, në përputhje me pikat 1.4, 1.5, 1.6, 1.7, 1.8, 1.9, 3.1, 3.2, 3.3, 3.4 dhe 3.5 të Seksionit II - Kushtet dhe kriteret e kualifikimit;
- e. **Angazhimet:** Ne angazhohemi të përfshijmë në planin e zhvillimit të parkut një institucion të akredituar të arsimit të lartë;
- f. **Nënkontraktorët:** Ne, në përputhje me pikat 19.1 dhe 20.2 të Udhëzimeve për Aplikantët, planifikojmë të nënkontraktoshim aktivitetet e mëposhtme dhe/ose aspekte të caktuara të angazhimeve të lidhura me këtë Projekt:
[Fut aktivitetet kryesore që Aplikanti synon të nënkontraktosh së bashku me informacion të plotë mbi nënkontraktorët/partnerët, kualifikimin dhe përvojën e tyre]
- g. **Përrjashtëmi nga detyrimet:** Ne e kuptojmë që ju, pa asnjë detyrim ndaj Aplikantëve, mund të anuloni procesin e kualifikimit në çdo kohë dhe se nuk jeni të detyruar të pranoni asnjë aplikim

që mund të merrni dhe as të ftoni Aplikantët e kualifikuar të propozojnë për marrëveshjen objekt i këtij procesi kualifikimi, në përputhje me pikën 21.1 të Udhëzimeve për Aplikantët.

- h. **Vërtetësia dhe saktësia e informacionit:** Të gjitha informacionet, deklaratat dhe përskrimet e përfshira në Aplikim janë në të gjitha aspektet të vërteta, të sakta dhe të plota në bazë të njohurive tona më të mira. Ne, autorizojmë Korporatën që të verifikojë informacionin dhe dokumentet bashkëlidhur me aplikimin.

Nënshkrimi _____ [fut nënshkrimin(t) e një përfaqësuesi(ve) të autorizuar të aplikantit]

[shëni emrin e plotë të personit që nënshkruan Aplikimin]

Në cilësinë e _____
[shëno cilësinë e personit që nënshkruan Aplikimin]

I autorizuar për të nënshkruar Aplikimin për dhe në emër të:

[shënoni emrin e plotë të Aplikantit]

Adresa _____
[fut numrin e rrugës/qytetit ose adresën e qytetit/vendit]

Datë _____ [fut numrin e datës, muajit, vitit]

[Për një Bashkim Subjektësh duhet të nënshkruajë vetëm përfaqësuesi i autorizuar, në këtë rast autorizimi për të nënshkruar në emër të të gjithë anëtarëve të Bashkimit të Subjekteve do t'i bashkëngjitet Letrës së Aplikimit]

Formulari 1.1

Kriteri Ligjor - Administrativ i Aplikantit

Data: *[fut ditën, muajin, vitin]*
 Emri i Projektit: Zhvillimi i parkut teknologjik dhe shkencor Durana Tech Park”
 Titulli i Kontratës: Menaxhimi/administrimi dhe ndërmjetësimi në përzgjedhjen e përdoruesve të “Durana Tech Park”

Faqe *[fut numrin e faqes]* prej *[fut numrin total]* faqet

Emri i Aplikantit <i>[fut emrin e plotë]</i>
Informacioni i përfaqësuesit të autorizuar të Aplikantit Emri: <i>[fut emrin e plotë]</i> Adresa: <i>[fut rrugën/numrin/ qytetin ose qytetin/shtetin]</i> Numrat e telefonit: <i>[futni numrat e telefonit, duke përfshirë kodet e shtetit dhe të qytetit]</i> Adresa e postës elektronike: <i>[tregoni adresën e postës elektronike]</i>
1. Bashkangjitur janë dokumentat si vijojnë: <ul style="list-style-type: none"> - Ekstrakt historik i regjistrimit të Aplikantit, lëshuar nga autoriteti kompetent. - Vërtetim që Aplikanti nuk është në proces falimentimi dhe/ose likuidimi. - Vërtetim që Aplikanti nuk është dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për vepra kundër pasurisë, në sferën ekonomike dhe veprimtarinë profesionale. - Vërtetim për përfituesit fundorë të Aplikantit (pronari përfitues).

Nënshkruar *[fut nënshkrimin(t) e një përfaqësuesi(ve) të autorizuar të aplikantit]*

Formulari 1.2

Kriteri Ligjor - Administrativ i Anëtarëve të Aplikantit

[Formulari i mëposhtëm është shtesë në Formularin 1.1., dhe do të plotësohet për të dhënë informacion në lidhje me secilin anëtar të bashkimit të subjekteve (në rast se aplikanti është bashkim subjektësh)

Emri i Aplikantit: *[fut emrin e plotë]*
 Data: *[fut ditën, muajin, vitin]*
 Emri i anëtarit të bashkimit të subjekteve: *[fut emri i plotë]*
 Emri i Projektit: Zhvillimi i parkut teknologjik dhe shkencor “Durana Tech Park”
 Titulli i Kontratës: Menaxhimi/administrimi dhe ndërmjetësimi në përzgjedhjen e përdoruesve të “Durana Tech Park”

Faqe *[fut numrin e faqes]* prej *[fut numrin total]* faqet

Emri i Aplikantit: <i>[fut emrin e plotë]</i>
Emri i anëtarit në bashkimin e subjekteve të Aplikantit: <i>[fusni emrin e plotë të anëtarit]</i>
Informacioni i përfaqësuesit të autorizuar të anëtarit të bashkimit të subjekteve të Aplikantit Emri: <i>[fut emrin e plotë]</i> Adresa: <i>[fut rrugën/numrin/ qytetin ose qytetin/shtetin]</i> Numrat e telefonit: <i>[futni numrat e telefonit, duke përfshirë kodet e shtetit dhe të qytetit]</i> Adresa e postës elektronike: <i>[tregoni adresën e postës elektronike]</i>
1. Bashkangjitur janë dokumentat si vijojnë: <ul style="list-style-type: none"> - Ekstrakt historik i anëtarit në bashkimin e subjekteve të Aplikantit, lëshuar nga autoriteti kompetent. - Vërtetim që anëtari në bashkimin e subjekteve të Aplikantit nuk është në proces falimentimi dhe/ose likuidimi. - Vërtetim që anëtari në bashkimin e subjekteve të Aplikantit nuk është dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për vepra kundër pasurisë, në sferën ekonomike dhe veprimtarinë profesionale. - Marrëveshja e bashkëpunimit ose Letra e qëllimit për të formuar marrëveshje bashkëpunimi për bashkimin e subjekteve. - Vërtetim për përfituesit fundorë të Aplikantit (pronari përfitues) të çdo anëtarit në bashkimin e subjekteve.

Nënshkruar *[fut nënshkrimin(t) e një përfaqësuesi(ve) të autorizuar të aplikantit]*

Formulari 2.1

Stabiliteti Ekonomik dhe Financiar

[Tabela e mëposhtme do të plotësohet për aplikantin dhe për çdo anëtar të një bashkimi subjektesh]

Emri i Aplikantit: *[fut emrin e plotë]*
 Data: *[fut ditën, muajin, vitin]*
 Emri i anëtarit të bashkimit të subjekteve: *[fut emri i plotë]*
 Emri i Projektit: Zhvillimi i parkut teknologjik dhe shkencor “Durana Tech Park”
 Titulli i Kontratës: Menaxhimi/administrimi dhe ndërmjetësimi në përzgjedhjen e përdoruesve të “Durana Tech Park”

Faqja *[fut numrin e faqes]* prej faqeve *[fut numrin total]*

1. Të dhënat financiare

Lloji i informacionit financiar në (monedhë)	Informacion historik për vitet e mëparshme <i>_[fut numrin],</i> <i>[fut me fjalë]</i> (shuma në monedhë, monedhë, kurs këmbimi*, ekuivalent në EURO)		
	Viti 1	Viti 2	Viti 3
Pasqyra e Pozicionit Financiar (Informacion nga Bilanci)			
Totali i aktiveve			
Detyrimet totale			
Kapitali total/Vlera neto			
Aktivet rrjedhëse			
Detyrimet korente			
Kapitali punues			
Informacion nga Pasqyra e të Ardhurave			
Të ardhurat totale			
Fitimet para taksave			
Informacioni i fluksit të parasë			
Flukset e parasë nga aktivitetet operative			

* Referojuni pikës 10.2 të udhëzimeve për aplikantët

2. Dokumentet financiare

Aplikanti dhe partnerët e tij do të ofrojnë kopje të pasqyrave financiare për tre (3) vite në përputhje me Seksionin II, Kushtet dhe Kriteret e Kualifikimit, nën-faktori 3.1. Pasqyrat financiare duhet të:

- (a) pasqyrojnë situatën financiare të aplikantit ose anëtarëve në JV-së, dhe jo të një entiteti të lidhur (siç është kompania mëmë ose anëtari i grupit).
- (b) të jetë i audituar ose i certifikuar në mënyrë të pavarur (në rast se aplikohet).
- (c) të jetë i plotë, duke përfshirë të gjitha shënimet në pasqyrat financiare.
- (d) korrespondon me periudhat kontabël tashmë të përfunduara dhe të audituara.

Bashkangjitur janë kopjet e pasqyrave financiare¹ për tre (3) vitet e kërkuara më sipër; dhe në përputhje me kërkesat.

Nënshkruar [*fut nënshkrimin(t) e një përfaqësuesi(ve) të autorizuar të aplikantit*]

¹Nëse grupi më i fundit i pasqyrave financiare është për një periudhë më të hershme se 12 muaj nga data e Aplikimit, arsyeja për këtë duhet të arsyetohet.

Formulari 2.2

Kapaciteti Financiar

[Tabela e mëposhtme do të plotësohet për aplikantin dhe për çdo anëtar të një bashkimi subjektësh]

Emri i Aplikantit: *[fut emrin e plotë]*
 Data: *[fut ditën, muajin, vitin]*
 Emri i anëtarit të bashkimit të subjekteve: *[fut emri i plotë]*
 Emri i Projektit: Zhvillimi i parkut teknologjik dhe shkencor “Durana Tech Park”
 Titulli i Kontratës: Menaxhimi/administrimi dhe ndërmjetësimi në përzgjedhjen e përdoruesve të “Durana Tech Park”

Faqja *[fut numrin e faqes]* prej faqeve *[fut numrin total]*

[Tabela e mëposhtme do të plotësohet për aplikantin dhe të gjitha anëtarët e kombinuar në rastin e një bashkimi subjektësh]

Specifikoni burimet e financimit në një masë për të përmbushur kërkesat e fluksit monetar për angazhimet e ardhshme të kontratës.

Nr.	Burimi i financimit	Shuma (ekuivalente në EURO)
1		
2		
3		

1. Dokumentat mbështetës

Jepni dokumente mbështetëse për burimet financiare si pasqyrat financiare, linjat e kreditit, letra interesi për financimin e projektit nga palë të treta, etj.

Nënshkruar [fut nënshkrimin(t) e një përfaqësuesi(ve) të autorizuar të aplikantit]

Formulari 3.1

Eksperienca e Ngjashme

[Tabela e mëposhtme do të plotësohet për aplikantin dhe për çdo nënkontraktor/anëtar të bashkimit të subjekteve]

Emri i Aplikantit: *[fut emrin e plotë]*
 Data: *[fut ditën, muajin, vitin]*
 Emri i anëtarit të bashkimit të subjekteve: *[fut emri i plotë]*
 Emri i Projektit: Zhvillimi i parkut teknologjik dhe shkencor “Durana Tech Park”
 Titulli i Kontratës: Menaxhimi/administrimi dhe ndërmjetësimi në përzgjedhjen e përdoruesve të “Durana Tech Park”

Faqja [fut numrin e faqes] prej faqeve [fut numrin total]

[Identifikoni kontratat/marrëveshjet që demonstrojnë punë/shërbime të ngjashme gjatë pesë (5) viteve të fundit të aplikantit apo të nënkontraktorëve/anëtarit në bashkimin e subjekteve. Rendisni kontratat në mënyrë kronologjike, sipas datave të fillimit (fillimit) të tyre.]

Fillimi viti	Përfundimi viti	Identifikimi i kontratës/projektit	Roli i Aplikantit/Anëtar it në bashkimin e subjekteve/Nënko ntraktorit
<i>[tregoni vitin]</i>	<i>[tregoni vitin]</i>	Emri i kontratës/projektit: <i>[fut emrin e plotë]</i> Përshkrim i shkurtër i aktiviteteve të ngjashme me ato të projektit të kryera nga Aplikanti/anëtari në bashkimin e subjekteve/nënkontraktori: _____ Vlera e aktiviteteve: <i>[fut shumën në monedhë, përmend monedhën e përdorur, kursin e këmbimit dhe ekuivalentin në EURO*]</i> Emri i Punëdhënësit/Partnerit: _____ Adresa: <i>[tregoni rrugën/numrin/qytetin ose qytetin/vendin]</i>	<i>[fut "Kontraktor Kryesor" ose "Anëtar në Bashkim Subjektësh" ose "Nënkontraktor" ose "Kontraktor Menaxhues"]</i>

* Referojuni udhëzimeve për kandidatët, pika 10.2, për datën dhe burimin e kursit të këmbimit.

PJESA 2 – Përshkrimi i projektit

Seksioni IV - Përshkrimi i Projektit

Përmbajtja

1. Qëllimi i Projektit dhe Kuadri Ligjor	34
2. Termat e Referencës	38
3. Informacioni mbi Pronën	44

1. Qëllimi i Projektit dhe Kuadri Ligjor

1. Qëllimi i projektit

Shqipëria, vitet e fundit ka bërë hapa të mëdhenj në investimin dhe konsolidimin e partneriteteve kyçe në tregjet e konsoliduara dhe në një sërë industrish të reja dhe në zhvillim, duke përfshirë teknologjinë e informacionit, inteligjencën artificiale dhe prodhimin industrial. Këto industri përfaqësohen nga organizata dhe korporata ndërkombëtare dhe shumëkombëshe, të cilat shpeshherë synojnë zgjerimin e aktivitetit të tyre në territore të reja dhe në zhvillim, duke sjellë në këto territore mundësi të konsiderueshme punësimi dhe rritje të kapaciteteve vendase përmes transferimit të njohurive.

Shqipëria është në një pikë kthese të rëndësishme ekonomike dhe shoqërore për shkak të një sërë sfidash transformuese të udhëhequra nga revolucioni i katërt industrial. Ky term përcakton përdorimin dhe zhvillimin e teknologjive dixhitale, automatizimin e proceseve prodhuese, inteligjencën artificiale, internetin e sendeve, robotikën, dhe avancimet e mëdha në fushën e informatikës dhe telekomunikacionit.

Për të qënë në lartësinë e sfidave në dekadat e ardhshme, qeveria shqiptare ka miratuar tre strategji kombëtare të rëndësishme të lartë:

- Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021-2027¹;
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030²;
- Strategjia Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023-2030³,

të cilat synojnë të përmbushin qëllime ambicioze në sektorin e ekonomisë dixhitale, inovacionit teknologjik, metodave bashkëkohore të sipërmarrjes dhe menaxhimit të biznesit.

Vizioni që ka ravijëzuar qeveria është një ekonomi shqiptare konkurruese, e nxitur nga inovacioni dhe e bazuar në njohuri, e cila krijon vende pune të reja dhe më cilësore, duke shfrytëzuar mundësitë që ofron transformimi digjital dhe transformimi i zinxhirit të vlerave ndërkombëtare, me theksin mbi zhvillimin e qëndrueshëm, integrimin evropian dhe atë rajonal.

Theksi është vënë në krijimin e ekselencës shkencore, tërheqjen e njerëzve të kualifikuar brenda sistemit shqiptar të ndërmarrjeve dhe kërkimit shkencor, forcimin e lidhjeve ndërmjet organizatave kërkimore shkencore dhe sektorit privat për të nxitur inovacionin si bazë për rritjen ekonomike dhe krijimin e vendeve të punës.

¹ <https://qbz.gov.al/share/BmpDqyOGT9Kkl4doU-vrYQ>

² <https://qbz.gov.al/share/CziCAqPkOiEëQq4TCnGR-g>

³ <https://qbz.gov.al/share/CziCAqPkOiEëQq4TCnGR-g>

Sfidat e identifikuara në kuadrin strategjik dhe rregullator, si rezultat i një ekosistemi të fragmentarizuar, përfshijnë sfida në sigurimin e financimeve për projektet inovative, kufizime në efikasitetin e transferimit të teknologjisë dhe nevojën për infrastrukturë më të plotë, siç janë parqet shkencore dhe teknologjike. Këto pengesa kanë frenuar potencialin e vendit për të arritur inovacion të qëndrueshëm dhe zhvillim të zgjeruar.

Për të adresuar këto çështje dhe për të inkurajuar sektorin privat të ndërmarre hapa të guximshëm drejt konfigurimeve ekonomike bashkëkohore, Kuvendi i Shqipërisë, me propozim të qeverisë dhe bazuar në strategjitë e mësipërme, ka miratuar dy ligje kyçe:

- **Ligjin nr. 25/2022, 10 mars 2022, "Për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Startup-eve"**, me qëllim ndërtimin e një kuadri rregullator dhe institucional të favorshëm për krijimin e zhvillimin e startup-eve si dhe mbështetjen e ekosistemit të tyre, për nxitjen e kërkimit, realizimit dhe përdorimit të ideve inovative, si dhe modeleve, produkteve dhe proceseve të reja.
- **Ligjin nr. 58/2022, 12 gusht 2022, "Për Krijimin, Organizimin dhe Funksonimin e Parqeve Teknologjike dhe Shkencore" (LPARK)**, me qëllim krijimin dhe funksionimin e parqeve teknologjike dhe shkencore në nxitjen e tyre për zhvillimin e industrive të teknologjisë së lartë dhe inovacionit, kërkim-zhvillimin për produkte dhe shërbime të reja dhe përmirësimin e atyre ekzistuese, si edhe krijimin e vendeve të kualifikuara të punës për profesionistë të fushave të shkencës e të teknologjisë.

“Durana Tech Park” është projektuar për të tërhequr dhe inkurajuar kompanitë e mëdha që operojnë në fushën e teknologjisë për të zhvilluar dhe zgjeruar operacionet e tyre në Shqipëri, duke i ofruar atyre një platformë unike për inovacion dhe zhvillim të produkteve të reja. Kjo nismë synon jo vetëm të stimulojë inovacionin në vend, por edhe të krijojë mundësi për kompanitë të eksportojnë teknologjitë dhe produktet e tyre jashtë shtetit, duke kontribuar kështu në integrimin dhe rritjen ekonomike të Shqipërisë në tregjet globale.

Me një fokus të veçantë në zhvillimin e qëndrueshëm, integrimin evropian dhe atë rajonal, “Durana Tech Park” pritet të luajë një rol vendimtar në nxitjen e krijimitarisë, bashkëpunimit dhe përparimit teknologjik. Ky park teknologjik do të shërbejë si një katalizator për tërheqjen e investimeve të huaja dhe do të vendosë Shqipërinë si një qendër për teknologjinë dhe sipërmarrjen në rajon dhe më gjerë. Angazhimi i Shqipërisë për të nxitur një ekosistem dinamik të inovacionit, bashkëpunimit dhe rritjes ekonomike është më i qartë se kurrë me realizimin e këtij projekti ambicioz.

2. Kuadri Ligjor

Në bazë të ligjit nr. 58/2022 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e parqeve teknologjike

dhe shkencore’’, Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimet:

1. Vendimin nr. 337, datë 31.5.2023 “Për përcaktimin e procedurave dhe kritereve të përzgjedhjes së zhvilluesit të parqeve teknologjike dhe shkencore”, i ndryshuar (“VKM – Zhvilluesi”)
2. Vendimin nr. 418, datë 7.7.2023, “Për miratimin e procedurave për përzgjedhjen e përdoruesit në parqet teknologjike dhe shkencore” (VKM – Përdoruesi)
3. Vendimin nr. 417, datë 7.7.2023 “Për përdorimin e pasurive të paluajtshme shtetërore në parqet teknologjike dhe shkencore dhe miratimin e modelit të kontratës së qirasë” (“VKM – Pasuritë e Paluajtshme”)
4. Vendim nr. 416, datë 7.7.2023 “Për miratimin e kritereve, rregullave dhe procedurave për përfitimin e lehtësirave fiskale nga zhvilluesit dhe përdoruesit që operojnë në parqet teknologjike dhe shkencore”, i ndryshuar (“VKM – Lehtësirat Fiskale”)
5. Vendim nr. 835, datë 28.12.2023 “Për disa shtesa në vendimin nr. 337, date 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe kritereve të përzgjedhjes së zhvilluesit të parqeve teknologjike dhe shkencore”
6. Vendim nr. 185, datë 27.03.2024, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi nga Radio Televizioni Shqiptar te Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit të pasurive të paluajtshme shtetërore nr.336, nr. 338/1, nr. 318 në zonën kadastrale nr. 3852, Xhafzotaj, Bashkia Durrës dhe miratimin e hapjes së parkut teknologjik dhe shkencor “Durana Tech Park”.

2.1. Lehtësirat fiskale – Zhvilluesi dhe Përdoruesi

Sipas nenit 12(1) të ligjit nr. 58/2022 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e parqeve teknologjike dhe shkencore” dhe akteve nënligjore për zbatimin e tij, si dhe legjislacionit për sigurimet shoqërore, Zhvilluesi dhe Përdoruesi (NIPT parësor / sekondar) në ushtrimin e veprimtarisë së tyre brenda parkut përfitojnë lehtësirat fiskale të mëposhtme:

1. lehtësira doganore në hyrjen dhe daljen e mallrave që shërbejnë në krijimin e produkteve inovative në park dhe jashtë tij;
2. furnizimi me mallra shqiptare që shërbejnë për nxjerrjen e produktit inovativ për përdorim brenda parkut, konsiderohen si furnizim për eksport me shkallë zero për sa i përket TVSH dhe legjislacionit doganor;
3. norma e tatimit mbi fitimin është zero për 15 vite rradhazi për të ardhurat e gjeneruara nga veprimtaria brenda parkut;
4. pagat e personelit që punon në kërkim-zhvillim të përdoruesit në park dhe i gjithë stafi i zhvilluesit përjashtohen nga të gjitha taksat për një periudhë 10-vjeçare;
5. përjashtohen nga TVSH-ja mallrat, pajisjet dhe shërbimet e përdorura në park, të cilat shërbejnë për nxjerrjen e “produktit inovativ”;
6. përjashtohen nga taksa e ndikimit në infrastrukturë;

7. përjashtohen nga taksat e pasurisë së paluajtshme për një periudhë 10 vjecare për ndërtimet e realizuara në park;
8. rimbursim pjesërisht nga shteti i kostove të trajnimit të punonjësve shkencorë dhe teknik sipas kritereve të vendosura nga Këshilli i Ministrave;
9. kontributet e sigurimeve shoqërore mund të paguhen në nivelin e pagës minimale mujore në shkallë vendi, me miratimin paraprak të punëmarrësit, pavarësisht pagës bruto të deklaruar për personat e punësuar me profesion në fushën e teknologjisë së informacionit.

2. Termat e Referencës

A. Partnerët kryesorë

1. Korporata në rolin e zhvilluesit të autorizuar

Me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 185, datë 27.03.2024, “Për kalimin nga Radiotelevizioni shqiptar në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, të pasurive të paluajtshme shtetërore nr. 336, nr. 338/1, nr. 318, në zonën kadastrale 3852, Xhafzotaj, Bashkia Durrës, dhe miratimin e hapjes së Parkut Teknologjik dhe Shkencor “Durana Tech Park””, Këshilli i Ministrave vendosi:

- a. t’i kalojë Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit disa pasuri të paluajtshme shtetërore të llojit truall me një sipërfaqe totale prej 262,200 m², me vendondodhje në Komunën Xhafzotaj, në Rrethin e Durrësit;
- b. në këtë truall të ndërtohet parku teknologjik dhe shkencor me emërtimin “Durana Tech Park”; si dhe
- c. autorizoi si zhvillues të këtij projekti, Korporatën e Investimeve Shqiptare (Korporata), një shoqëri tregtare aksionare me kapital 100% shtetëror, e cila ka si aksionar të vetëm shtetin, p Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

Korporata organizohet dhe funksionon në bazë të ligjit nr. 71/2019, datë 17.10.2019, “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare”.

Sipas nenit 5(1) të ligjit “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare”, Korporata ka si funksion të zhvillojë dhe menaxhojë pronat, si edhe projektet në mbështetje të politikave shtetërore të zhvillimit. Ky funksion përkon me qëllimin e ligjit “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e parqeve teknologjike dhe shkencore”, i cili synon t’i japë hov sektorit të teknologjisë së informacionit nëpërmjet zhvillimit të parqeve teknologjike, parqe të cilat janë planifikuar si politika shtetërore të zhvillimit.

Në përmbushjen e detyrave të saj si zhvillues, në përputhje me VKM 337, 31.05.2023 “Për Procedurat dhe Kriteret e Përzgjedhjes së Zhvilluesve të Parqeve Shkencore dhe Teknologjike”, i ndryshuar, Korporata synon të hyjë në një partneritet, me subjekte private nëpërmjet një procedure konkurruese në qëllim menaxhimin/administrimin dhe funksionimin e Parkut, si dhe të mundësojë përzgjedhjen në mënyrë profesionale të përdoruesve. Partneriteti ndërmjet Korporatës dhe partnerit privat mund të marrë formën ligjore të një Shoqërie Tregtare me Qëllim të Vecante

(“SPV”).

Korporata synon të krijojë një hapësirë inovative që tërheq kompani të njohura ndërkombëtare të teknologjisë. Këto kompani do të përdorin parkun si një platformë për të inovuar dhe zhvilluar produkte dhe shërbime të reja. Ky model përfshin bashkëpunimin e ngushtë mes start-upeve, nomadëve digjitalë, universiteteve me kapacitete zhvillimore e shkencore dhe qendrave kërkimore, të cilët do të ndërveprojnë brenda parkut për të stimuluar ekonominë, inovacionin dhe kërkimin shkencor.

Korporata synon të krijojë një ekosistem dinamik ku burimet njerëzore, financimi dhe infrastruktura teknologjike avancuar vihen në dispozicion të të gjithë aktorëve. Ky ekosistem është dizajnuar për të përshpejtuar ritmin e avancimeve teknologjike dhe për të maksimizuar sinergjitë që nxisin rritjen e ndërsjellë dhe shkëmbimin e njohurive.

Startup-et kanë një rol të rëndësishëm në këtë model, me hapësira të dedikuara për inkubacion, programe mentorimi dhe mundësi të shumta financimi. Duke i vendosur këto në qendër të parkut, pranë kompanive të teknologjisë dhe institucioneve akademike, sinergjitë e krijuara janë të destinuara për të nxitur inovacionin dhe zhvillimin.

Për më tepër, Parku Teknologjik dhe Shkencor është një destinacion ideal për nomadët digjitalë, ofruar hapësira fleksibël dhe të pajisura me teknologjinë më të avancuar. Kjo përfshirje garanton tërheqjen e një gamë të gjerë talentesh dhe ekspertizash, duke krijuar një mjedis të pasur bashkëpunimi ku ide të reja lindin dhe zbatohen lirshëm.

Partneriteti strategjik me institucione të arsimit të lartë siguron një lidhje të drejtpërdrejtë me nevojat e tregut dhe trendet e industrisë, duke e bërë parkun një qendër të fuqishme për konvergencën e akademisë, startup-eve, dhe korporatave të mëdha të teknologjisë, të gjitha bashkëpunuese për të nxitur inovacionin, rritjen ekonomike dhe përhapjen e dijes.

2. Menaxhuesi/administruesi i parkut

Korporata, në rolin e zhvilluesit të autorizuar, po zhvillon një procedurë konkurruese për marrjen e propozimeve për zgjedhjen e një menaxhuesi/administruesi të parkut me qëllim që në bashkëpunim të sigurojnë përmbushjen e kushteve të nevojshme për zhvillimin dhe menaxhimin e parkut.

Në çdo rast, zhvilluesi i autorizuar mbetet përgjegjës për detyrimet e tij ndaj institucionit përgjegjës dhe organeve shtetërore.

Gjithashtu, partneri duhet të provojë që angazhon/tërheq përdorues të cilët duhet të jenë sa më shumë në numër (në çdo rast jo më pak se 5) por edhe me kapacitete financiare dhe profesionale të tilla (jo më pak se 1 përdorues i listuar në një nga bursat e vendeve të OECD) që të mund të sigurojnë një park teknologjik eficient dhe me një model biznesi të suksesshëm.

Për zhvillimin dhe menaxhimin e parkut, Korporata ofron modelin potencial të menaxhimit nëpërmjet krijimit të një SPV, në formën e një shoqërie tregtare të përbashkët, të krijuar me kandidatin fitues.

3. Përdoruesit e parkut

Zhvilluesi përzgjedh përdoruesit e parkut sipas procedurave të miratuara me akte nënligjore të dala në zbatim të ligjit të ligjit nr. 58/2022, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e parqeve teknologjike dhe shkencore”, si dhe në bazë të rregullores së Korporatës për procedurën e konkurimit për përzgjedhjen e partneriteteve, dhe hyn në marrëdhënie kontraktuale me ta.

Kandidati për përdorues, vetë apo nëpërmjet partnerit menaxhues/administrues duhet të paraqesë bashkëlidhur kërkesës dokumentacionin e mëposhtëm:

- a. ekstraktin e regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit, si dhe ekstraktin për historikun e subjektit;
- b. vetëdeklarimin se subjekti ka shlyer detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore;
- c. vetëdeklarimin që nuk është në ndjekje penale, si dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin;
- d. vetëdeklarimin që nuk është në proces falimentimi dhe kapitalet e tij nuk janë në proces ekzekutimi nga përmbaruesit;
- e. studimin e fizibilitetit për veprimtarinë që do të ushtrojë në park.

Kur kandidati për përdorues është person fizik, juridik, i huaj, duhet të paraqesë dokumentin zyrtar i cili vërteton se ai është i regjistruar në regjistrat përkatës tregtarë ose dokument të ngjashëm, të lëshuar nga institucionet përkatëse në shtetin e origjinës.

Dokumentet e siguruar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nga subjekte juridike të huaja duhet të jenë të noteruara, në zbatim të legjislacionit në fuqi për ligjërimin e dokumentacionit të shtetasve të huaj që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë.

Kandidati për përdorues nuk mund të marrë statusin e përdoruesit të parkut nëse i nënshtrohet një ose më shumë kufizimeve të mëposhtme:

- a. 25 ose më shumë për qind e kapitalit të autorizuar, direkt ose indirekt, i përket organeve të qeverisjes qendrore ose vendore;
- b. organizohet si organizatë jofitimprurëse sipas përcaktimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për organizatat jofitimprurëse;
- c. në kapitalin e autorizuar të të cilit 25 për qind ose më shumë janë në pronësi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga persona juridikë të regjistruar, të shpallur në listën e financuesve të terrorizmit;
- d. kur ai shpallet i falimentuar në përputhje me dispozitat në fuqi të ligjit për falimentimin;
- e. kur është në proces likuidimi, përveç transformimit.

B. Veprimtaritë e lejuara në park

Llojet e veprimtarive që do të zhvillohen në park janë:

- a. Disenjim softëare-i. Këtu përfshihet, por nuk kufizohet analiza e kërkesave të sistemeve softëare, projektimi i arkitekturës dhe disenjim i detajuar i këtyre sistemeve;
- b. Zhvillimi dhe mirëmbajtja e sistemeve softëare. Këtu përfshihet, por nuk kufizohet në programim e sistemeve softëare, kodimi, instalimi, integrimi i të gjithë komponentëve, dokumentacioni, identifikimi dhe korrigjimi i gabimeve, modifikimet (pas vënies në punë të softëare-it), mirëmbajtja e të gjithë komponentëve, mbështetja e sistemit si një grup komponentësh që, në funksionimin e tyre, përmbushin qëllimin e zgjidhjes së teknologjisë së informacionit;
- c. Testimi i softëare-it. Këtu përfshihet, por nuk kufizohet në testimin e funksionalitetit, ngarkesës së punës, performancës, problemeve të kodit, disponueshmërisë dhe sigurisë së sistemit softëare;
- d. Projektimi dhe zhvillimi i sistemeve të komunikimit. Këtu përfshihet, por nuk kufizohet analiza, planifikimi, projektimi, zbatimi, vënia në punë dhe mirëmbajtja e sistemeve të komunikimit të rrjetit të pajisjeve të teknologjisë së informacionit (LAN/ëAN/ëLAN/MAN/SAN/CAN);
- e. Projektimi dhe zhvillimi i sistemeve të sigurisë. Këtu përfshihet, por nuk kufizohet, analiza e kërkesave të sigurisë së klientit, projektimi i arkitekturës, instalimi dhe konfigurimi i komponentëve, zbatimi, testimi dhe mirëmbajtja e sigurisë së sistemeve dhe produkteve;

-
- f. Zhvillimi i sistemeve të migracionit. Këtu përfshihet, por nuk kufizohet, transferimi i të dhënave dhe infrastrukturës përkatëse nga një teknologji e vjetër në një të re dhe përmirësimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit;
 - g. Analiza e sistemeve me sasi të madhe të dhënash. Analiza e sistemeve të përpunimit dhe analiza e sasive të mëdha të të dhënave, të quajtura si Big Data. Mbi bazën e këtyre të dhënave mund të ndërtohen modele, të cilat, më pas, me përdorimin e inteligjencës artificiale mund të shfrytëzohen për aktivitete biznesesh të ndryshme;
 - h. Konsulencë për inovacion. Konsulencë për përdorimin e teknologjisë së informacionit për qëllime të inovacionit (riinxhinierimit) të proceseve të biznesit me zhvillimin e kërkesave teknike për sistemet e informacionit dhe softëare;
 - i. Konsulencë për sigurinë e informacionit. Konsulencë për mbrojtjen teknike dhe kriptografike të informacionit, duke përfshirë përdorimin e nënshkrimit elektronik digjital;
 - j. Konsulencë në auditime, operacione, menaxhim, mbështetje e përdoruesve, trajnime dhe konsulencë për auditime të teknologjisë së informacionit për sistemet softëare;
 - k. Kërkime në fushën e komunikimit. Kërkim dhe zhvillim në fushën e shkencave natyrore dhe teknike që përfshijnë teknologjitë e informacionit e të komunikimit;
 - l. Kërkime në fushën e zhvillimit të programeve inovative. Kërkimi dhe zhvillimi nënkupton aktivitete krijuese dhe sistematike të ndërmarra për të rritur grupin e njohurive dhe për të krijuar aplikime të reja të njohurive të disponueshme. Termi kërkim dhe zhvillim përfshin tri lloje të kërkimit:
 - i. kërkimin bazë;
 - ii. kërkimin e aplikuar;
 - iii. zhvillimin eksperimental.
 - m. Kërkimi dhe zhvillimi në fushën e robotikës. Projektimi (inxhinierimi), kërkimi, testimi i aktiviteteve që përfshijnë teknologjitë robotike, pajisjet dhe sistemet që përdorin sisteme të kompjuterizuara kontrolli;
 - n. Aktivitete në fushën Cloud Computing. Kërkime në Cloud Computing dhe vlerësimin e rrezikut të migrimit të shërbimeve on-premises drejt shërbimeve Cloud;
 - o. Veprimtari të tjera në fushën e teknologjisë së informacionit, të përcaktuara nga institucioni përgjegjës, sipas autorizimit të këtij vendimi.

D. Propozimi fillestar dhe Plani i Zhvillimit

Partneri privat në propozimin e tij fillestar (vetëm aplikanti i kualifikuar) do të paraqesë planin e zhvillimit të detajuar/menaxhimit të parkut, i cili përfshin, ndër të tjera, të dhënat e mëposhtme:

- a. vlerën e investimit,
- b. burimin dhe mënyrën e financimit,
- c. listën e përdoruesit potencial,
- d. rolin specifik të një universiteti,
- e. plan-biznesin,
- f. partneritete të mundshme,
- g. grafikun, fazat dhe afatet e ekzekutimit të investimeve për zhvillimin e parkut,
- h. vlerësimin e ndikimit social, ekonomik, mjedisor e strategjik të projektit, dhe
- i. strukturën organizative të drejtimit.

Pas përzgjedhjes së partnerit privat, Korporata do të nënshkruajë një kontratë me partnerin privat mbi bazën e propozimi të negociuar të tij (propozimi përfundimtar). Në përfundim ndërmjet partnerëve do të dakortësohet plani i zhvillimit të detajuar dhe menaxhimit të parkut.

Ky plan do të dërgohet nga Korporata për miratim në ministrinë përgjegjëse për ekonominë, e cila do të vlerësojë planin për aspektet e mëposhtme:

- a. propozimi i projektit teknik;
- b. vlerësimi i ndikimit social, ekonomik dhe strategjik të projektit;
- c. impakti mjedisor;
- d. grafiku, fazat dhe afatet e ekzekutimit të investimeve për zhvillimin e parkut;
- e. plan-biznesi;
- f. garanci bankare për kapitalin e nevojshëm financiar për kryerjen e investimit në park.

Pas vlerësimit të planit të zhvillimit të detajuar si më sipër, ministria përgjegjëse për ekonominë, i propozon Këshillit të Ministrave miratimin e tij së bashku me kontratën e qirasë për përdorimin e pasurive të paluajtshme shtetërore.

D. Termat Kryesorë të Kontratës së Menaxhimit/Administrimit

Termat kryesorë të kontratës së menaxhimit/administrimit, si dhe udhëzimet për zbatimin e kritereve bazë plus, kriterit përzgjedhës përcaktohen në dokumentin e Fazës II (negociimit dhe përzgjedhjes), e cila do t'u dërgohet Kandidatëve të kualifikuar të Fazës I.

3. Informacioni mbi Pronën

Prona ku do të zhvillohet “Durana Tech Park” është përcaktuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 185, datë 27.3.2024, “Për kalimin nga Radiotelevizioni Shqiptar në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, të pasurive të paluajtshme shtetërore nr. 336, nr. 338/1, nr. 318, në zonën kadastrale 3852, Xhafzotaj, Bashkia Durrës, dhe miratimin e hapjes së Parkut Teknologjik dhe Shkencor “Durana Tech Park”.

Konkretisht, në lidhje me pronën vendimi përcakton sa vijon:

1. Kalimin nga Radiotelevizioni Shqiptar në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, të pasurive të paluajtshme shtetërore me nr. 336, me sipërfaqe 140 400 (njëqind e dyzet mijë e katërqind) m², nr. 338/1, me sipërfaqe 40 600 (dyzet mijë e gjashtëqind) m², dhe nr. 318, me sipërfaqe 81 200 (tetëdhjetë e një mijë e dyqind) m², e llojit “truall”, në zonën kadastrale 3852, me emërtimin “Radiostacioni”, me vendndodhje në Xhafzotaj, Bashkia Durrës, sipas dokumentacionit/kartelave të pronësisë, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, për t’u përdorur për krijimin/hapjen e parkut teknologjik dhe shkencor “Durana Tech Park”.
2. Miratimin e hapjes së parkut teknologjik dhe shkencor, me emërtimin “Durana Tech Park”, me sipërfaqe 140 400 (njëqind e dyzet mijë e katërqind) m², me vendndodhje në Xhafzotaj, Bashkia Durrës, në pasurinë me nr. 336, e llojit “truall”, në zonën kadastrale 3852, sipas kufijve dhe shtrirjes territoriale, që përcaktohen në fragment-hartat kadastale, më poshtë.

Nr.	Zona Kadastrale	Nr.Pasurisë	Emërtimi	Sipërfaqja (m ²)	Statusi i Pronësisë
1	3852	336	Radiostacioni	140,400	Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
2	3852	338/1	Radiostacioni	40,600	Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
3	3852	318	Radiostacioni	81,200	Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
				<u>262,200</u>	

Gjithashtu, duke konsideruar sipërfaqet e pronës shtet në afërsi të zonës së deklaruar të parkut dhe

situatën hapsinore të zonës rreth parkut ekziston mundësia e zgjerimit të parkut në mbi 825,000 m², kjo në varësi edhe të nevojave të parashikuara në planin e zhvillimit.

Pozicioni i pasurive në hartën kadastrale të pasurive:



